

HYLLI I DRITËS

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.

(II. ad Cor. III. 17).

Në dhetyjetorin e Mbretnis Shqyptare Fq. 433

CASHTJE FILOZOFIKE

Problemi i Njohëtes
(Dr. P. Gjon Shllaku, o. f. m.) .. 444

PROBLEM SOCJOLOGJIE

Shka është Komunizmi
(p. v.) .. 451

VJERRSHE

Nidermjet të Shën Gjergjavet
(P. Bernardin Palaj, o. f. m.) .. 462

PJESA HISTORIKE

„Shqiptari“ i 1912-s
(Shpend Bardhi) .. 469

Dorëshkrime të Bibliotekës Nacionale të Parisit .. 480
(Filip Fishta)

Historija e Bibliotekave në Shqipërië
(Bardhyli)

NOVELA E „HYLLIT“

Ana Mëhije Fatakeqe 485
(Andre Skarjetë)

DREJTËSI

E drejta kishtare
(Zef Zajzë) .. 492

ARSIM E EDUKATË

Kaluer ujkut, britu qëjvet
(Gjin Shpata) .. 496

„Shkolla Kombtare“ (F.-a.) .. 500

Lojët kontare
(P. Donat Kurti, o. f. m.) .. 503

RIVISTA E SHTYPIIT

Lajme rrokull Shqyptaris e rreth botës
Pralla. — Fash. 9. .. 511

(P. Donat Kurti o. f. m.)

VJETA XIV — Shtatuer 1938 — NUMRI 9.

Shtypshkroja Françeskane — Drejtumi: „Hylli i Dritës“ Shkoder

Botime të reja:

A. BERNARDIN PALAJ, O.F.M. e A. DONAT KURTI O.F.M.

UISAKET E KOMBIT

Nr. 4. Vëllimi II: KANGË KRESHNIKËSH dhe LEGENDA

Ësht një nder botimet e Komisionit të Kremtimevet të 25-vjetorit të vetëverimit 1912-1937. Në një volum të hieshem e me letër të mirë, me një shtuell 400 faqesh janë përmbledhë 34 kangë Kreshnikësh e II Legenda shumë bukra. Libri, me një çmim kaq 'ulët qi ká, është mirë të gjindet në dorë të çdo Shqyp-tarit.

Çmimi vetem : Fr. ari **1.**

P. VINÇENC PRENNUSHI, O. F. M.

FABIOLA

KISHA NEN DHË E MBI DHË

e Karð. WISEMAN, Pjesa e I., *botim i dytë.* Çmimi Fr. **1.**

Gjë e rrallë për vendin tonë : botohet për së dytë një liber, një romanz, qi dilton se sa me ande e ká këndue një kesi soj veprë publiku shqypiar. Ky botim është fort më i plotsuem se ai i pari, i përmirsuem për kah mënyra e shkrimit e i pastruem prej ndonjij gabimi të perparshem, si edhe me një petk tipografik më të hieshem, prandej është gjithë uzdaja se ky botim i dytë ká me gjetë pelqim gjithësesi e ká me knaqë zëmrat e gjithë njatyne, qi, si e dishmuen të lypunat e padame, e priten atë me padurim.

P. DONAT KURTI, O. F. M.

VEPRA KULTURALE E ELEMENTIT KATOLIK NË SHQYPNÍ

Botim i „*Hyllit të Dritës*“ Broshurë 30 fq. me çmim : Fr. ari **0.10**

Broshurá, qi sot paraqesim, është e botueme qyshë në vj. 1933, por nuk kje shpërdá për shkak të rrethanave të ndryshme. — E dijim se në ndo 'i pikë-pamje është e mangët, kah gjalë këtyne pesë vjetve kanë dalë në dritë e janë shkjarue shumë çashtje, e vepra e katolikvet për kulturë të vendit ká vijue pá pushue me energji të reja. Me gjithë këta knjtojm, se edhe kështu si është, ká brumë të mjaftueshem për me u a mbushë mendjen gjithë njatyne, qi s' duen me e diejtë se, *katolikët janë pionierët e vertelët e punlorët e palodhshem në të inkambun t' Atdheut tonë.*

Në dhjetjetorin e Mbretnisë shqiptare

Jo, po: a s' desht djalli Shqypní?

Jo, po: a s' desht hasmi Shqyptarë?

Qe, pra, sod po ká Shqypní!

Qe, pra, sod po ká Shqyptarë!

Mirizi i Zanave

Kohen e Sulltan Abdul Hamidit paska pasë kënë ngrefë dikû atje në Stambollë një *soirée* i madhnueshem, në të cillin paskan pasë marrë pjesë mâ të naltat auktoritete civile e ushtarake, si edhe gjith trupi diplomatik, besatue pranë Sulltanit.

Në ket *soirée*, nder sa fjalë tjera thohet, se paska pasë rá biseda mbí forcë të Pushtetevet të mdhá të botës. Mâ e fortë se Anglija, thote bajlozi ingliz, s' ká mbí ftyrë të tokës; pse Mbreti i ynë zotnon mbí 400 miljon e má frýmë njerzish: kemi mâ të madhen flotë të botës: kemi mjete të pashterrshme lufte, e mâ teper inglizi besen e fjalen e ká disì *kaucukut*... kshtû qi del edhe mâ i fortë, per qellimet e veta. Jo, thote bajlozi i Francës, as Inglizi s' ásht mâ i fortë se Franca, tue kënë se populli i Francës ásht mâ i pasuni i Europës, e madjë, francezt janë edhe trima — e njimend, janë trima francezt. Trima janë edhë tedeshkt, i a priti bajlozi german. E vertetë se s' kemi aq pare, por luften e rregullen i kemi zanát, e kshtû u a bâjm hallin edhë pareve... Ktij krahi foli aj i Moskovit, i Shtetevet të Bashkueme etr. etr. Kur, qe, po u bjen nder fjalë një farë Deli Pashe, e u thotë: Nji qind fjalë per një pare, zotní të mí! E fortë Anglija, e fortë sa të thuesh Alemanja, e s' dij se kush tjetër i fortë; por mbí ftyrë të tokës s' ká Pushtet mâ të fortë se Turkija. Janë 30 vjet qi ju së jashtmi e na së permbrendi jemi tue u mundue me

